

Tarifat e Lidhjes shkëputur nga “Rregullorja e Proçedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e lidhjeve ekzistuese në Sistemin e Transmetimit” të miratuar me vendim të Bordit të ERE me nr.87, datë 20.04.2018.

4.6.3. Tarifat e lidhjes konsistojnë në:

- (a) **Tarifa për Aplikim** (tarifa për mbulimin e kostove të studimit të pranueshmërisë së lidhjes ose modifikimit të saj në rrjetin e transmetimit, përgatitjes së dokumentacionit për marrëveshjen e lidhjes me përdoruesin apo amendimeve të nevojshme). Kjo tarifë është fikse dhe do të paguhet në vlerën 500,000.00 Lekë, në momentin e aplikimit nga përdoruesi.

- (b) **Tarifa për Mbikqyrje** (tarifa për mbulimin e kostove për kontrollin dhe vlerësimin e projektit teknik, mbikqyrjen e ndërtimit, testimit dhe komisionimit të lidhjes/modifikimit). Kjo tarifë do të jetë variabël, në funksion të fuqisë së plotë të kërkuar, të deklaruar nga përdoruesi dhe do të ketë vlerën 50 Leke/kVA, por në të gjitha rastet nuk do të jetë më e madhe se vlera kufi prej 2,500,000.00 Lekë. Paguesa e kësaj tarife bëhet nga aplikuesi në momentin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Lidhjes apo të amendimit të saj në rastin e lidhjeve ekzistuese dhe është parakusht për nënshkrimin e Marrëveshjes.